



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:097804
Datë: 27.05.2024
Numri i dokumentit: 05739029

Ac.nr.3169/21

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Arsim Hamzaj - kryetar i kolegjit, Besnik Bislimaj e Besnik Feka - anëtarë të kolegjit, në çështjen juridike kontestimore të paditësit A.T nga P,,,, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson av.S.K nga P,,,, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, për shkak të kompensimit të ushqimit gjatë punës (shujtave) dhe shpenzimeve të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1943/20, të datës 14.01.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **27.05.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Komuna e Prishtinës - Drejtoria Komunale e Arsimit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - departamenti i përgjithshëm, C.nr.1943/20, i datës 14.01.2021, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

Gjykata e shkallës së parë, me aktgjykimin e atakuar, C.nr.1943/20, të datës 14.01.2021, ka vendosur decidivisht si në vijim: *“I.APROVOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit A.T kundër të paditurës Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me adresë në Prishtinë, si e bazuar. II.DETYROHET e paditura Komuna e Prishtinës – Drejtoria Komunale e Arsimit, me adresë në Prishtinë, që paditëses, në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës (shujtave ditore) për 728 ditë pune (nga data 18.04.2017 deri me datë 14.12.2020) t’ia kompensoj shumën prej 1456 euro, ndërsa në emër të shpenzimeve të udhëtimit t’ia kompensoj shumën prej 407.68 euro, e në total shumën prej 1863.68 euro në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim. III. DETYROHET e paditura që shumën totale të gjykuar si në pikën II të këtij dispozitivi, paditësit A.T t’ia paguaj*

më kamatë ligjore prej 8%, nga data 14.01.2021 (data e marrjes së aktgjykimit), e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës në lartësi prej 259.00 €, në afatin prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit me detyrim.”

Kundër këtij aktgjykimi, e paditura në afat ligjor ka paraqitur ankesë, duke e atakuar të njëjtin për shkak të shkeljes së dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar apo jo të plotë të gjendje faktike, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit aktgjykimin e goditur ta ndryshon dhe kërkesëpadinë e paditësit ta refuzon si të pabazuar.

Paditësi, përmes përfaqësuesit së tij të autorizuar ka parashtruar përgjigje ndaj ankesës së palës së paditur me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet dhe aktgjykimi i atakuar të vërtetohet.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës të nenit 194 dhe 195, të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

- Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rezulton se paditësi A.T, nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar, me datën 13.05.2020 ka ushtruar padi në gjykatën shkallës së parë, kundër të paditurës Komuna e Prishtinës, për shkak të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, ndërsa në seancën përgatitore ka bërë zgjerimin e padisë duke kërkuar edhe kompensimin e shpenzimeve të udhëtimit, me arsyet sikurse në padi.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, ka mbajtur shqyrtimin kryesor dhe pas administrimit të provave të propozuara nga palët ndërgjyqëse ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1943/2020, të datës 14.01.2021, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetimin e aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka theksuar se në bazë të gjendjes faktike të vërtetuar dhe provave të administruara në këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit duhet të aprovohet si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Andaj, gjykata e shkallës së parë ka vendosur t’ia njoh të drejtën paditësit në kompensimin e shpenzimeve të ushqimit gjatë ditëve të punës dhe udhëtimit, duke u bazuar në nenin 35 par.5 dhe par.7 të Kontrata Kolektive të Arsimit të dt.18.04.2017. Për kamatën ka vendosur në bazë të nenit 382 të LMD-së, ndërsa për shpenzimet e procedurës konform nenit 452 par.1 të LPK-së. *(më gjerësisht si në arsyetim të aktgjykimit të atakuar)*

Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të

LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2 pika (n) e LPK-së. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet vendimtare për themelësinë e kërkesëpadsisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar.

Po ashtu gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese. Nga provat që ka administruar gjykata e shkallës së parë është vërtetuar se paditësi është i punësuar tek e paditura si mësimdhënës i Muzikës në SHFMU “Pavarësia” në P., gjë që është vërtetuar me anë të kontratës së punës e lidhur në kohë të pacaktuar dhe ka udhëtuar për në vendin e punës 728 ditë pune, ku 70% e biletës i ka kushtuar 0.56 €.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, kjo për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 të datës 01.11.2010, përcaktohet se “*Marrëveshja Kolektive mund të lidhet në mes: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve. Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) të nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në gjuhën zyrtare të Republikës së Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive*”.

Me nenin 35 par.5 të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, e cila ka hyrë në fuqi më 18.04.2017, parashihet se “*Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban*”. Po ashtu në nenin 35 par.7 të kësaj kontrate parashihet se “*Të punësuarve, u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucione arsimore. Punëdhënësi i cili e ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim*”. Andaj mbi bazën e të lartcekurave, kjo gjykatë gjeti se gjykata e shkallës së parë drejtë ka vendosur kur e ka aprovuar kërkesëpadsinë e paditësit si të bazuar, për çka edhe vendosi që të njëjtin ta vërtetoj sikurse në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e lartcekura, Gjykata e Apelit e aprovon në tërësi arsyetimin e aktgjykimit të gjykatës së shkallës së parë sa i përket vendosjes lidhur me aprovimin e kërkesëpadsisë së paditësit që në emër të shpenzimeve të udhëtimit dhe ushqimit t’ia kompensojë shumën e aprovuar si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar. Gjithashtu edhe për lartësinë e kërkesëpadsisë

gjkata e shkallës së parë ka vendosur drejtë dhe në mënyrë të ligjshme, pasi që në shkresat e lëndës ka pasur prova të mjaftueshme siç është kontrata e punës, vërtetimi mbi dëshminë e vendbanimit, çmimin e biletave, nga të cilat edhe është vërtetuar saktësisht lartësia e kërkesëpadisë, andaj dhe u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në këtë drejtim edhe vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozita e LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifat për shpenzime gjyqësore. E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën.

Gjkata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga arsyet e cekura Gjykata e Apelit, gjeti se gjykata e shkallës së parë në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme ka vendosur në këtë çështje juridike, prandaj në mbështetje të dispozitave nga neni 194, 195 par. 1 pika d) të LPK-së, lidhur me neni 200 të LPK-së, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË
Ac.nr.3169/21, datë 27.05.2024

Kryetari i kolegjit - gjyqtari,
Arsim Hamzaj